



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Shqyrtimi ne parim i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Spartak Braho, Elena Xhina, Adnor Shameti, Anduel Xhindi, Myslim Murrizi, Ylli Shehu, Milva Ekonomi.

Mungon:

Elona Hoxha.

Të ftuar:

Vasilika Hysi- deputete, anëtare e Komisionit të Ligjeve

Alfred Progonati – përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme

Kujtim Luli- përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Falënderoj kolegët për prezencën!

Fillojmë mbledhjen e radhës të Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Rendi i ditës së kësaj mbledhjeje është miratimi në parim i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Për të gjithë të pranishmit edhe ata që i bashkohen këtij komisioni, dua t’ju bëj me dije se më herët ky projektligj është prezantuar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare nga zonja Vasilika Hysi, e cila është edhe firmëtare e këtij projektligji.

Po ashtu dua të kujtoj se projektligji “Për Policinë Gjyqësore” është një ndër projektligjet e paketës së reformës në drejtësi. Kolegët më të vjetër e dinë se Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi edhe në vijim pasi kishim miratuar ligjet kryesore të kësaj pakete iu dha atribut nga Kuvendi i Shqipërisë që të vijonte edhe me përgatitjen e plotë të projektligjeve të tjera që duhet të shoqërojnë paketën e ligjeve të reformës në drejtësi. Këto projekte, të cilat u përgatitën nga ekspertë të ardhur nga jashtë, por që kanë punuar në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë u nënshkruan nga deputetë që ishin pjesë e Komisionit për Reformën në Drejtësi, në rastin konkret për ligjin, të cilin jemi duke folur projekti është nënshkruar nga zonja Vasilika Hysi.

Në këtë komision nuk është bërë votimi në parim i projektligjit. Kjo edhe për faktin se gjatë prezantimit u ngrit edhe nga propozuesja, u pa edhe nga diskutimet e kolegëve, se projekti kishte nevojë të punohej edhe më tej. Në dijeninë time si kryetare e Komisionit në projekt janë bërë shumë ndryshime, të tilla, që ndoshta e kanë ndryshuar në një masë të madhe, duke sjellë para nesh një projekt të ri, le të themi në të shkruar, në përmbajtje. Besoj që projekti të ketë ruajtur linjat kryesore që parashikon Kodi i Procedurës Penale lidhur me funksionimin e Policisë Gjyqësore, sepse nuk mundemi që me këtë ligj, i cili miratohet me shumicë të thjeshtë në Kuvendin e Shqipërisë të dalim jashtë standardeve kryesore të funksionimit të Policisë Gjyqësore që parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Për t’u njohur me përmbajtjen e projektit të punuar tashmë nga grupi i punës, menduam të ftojme zonjën Hysi, e cila dhe formalisht mbetet propozuesja e projektit. Besoj se zonja Hysi duhet të ishte në komisionin tonë për të prezantuar, atë çfarë ka ndryshuar në projekt, si grup interesi, por edhe si grupi që impaktohet më së shumti nga projekti.

Kemi edhe dy përfaqësues të prokurorisë së Përgjithshme, prokurorët: zotin Alfred Progonati dhe zotin Kujtim Luli.

Ju falënderoj që keni ardhur në Komisionin për Sigurinë Kombëtare!

Do t'ia jap fjalën fillimisht zonjës Hysi për të na prezantuar përmbajtjen e projektit të sjellë nga grupi i punës të depozituar në Kuvendin e Shqipërisë.

Më pas do të doja të dëgjoja opinionin e dy prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme për këtë projekt.

Pastaj sipas Rregullores do të vijomë me pyetjet nga kolegët për të sqaruar momentet kryesore të këtij ligji.

Përpara se t'ia jap fjalën zonjës Hysi, dua t'ju bëj me dije kolegë se përpara jush ndodhet projekti, siç ka ardhur në momentin e parë në Kuvendin e Shqipërisë. Keni projektin e grupit të punës, të definuar nga grupi i punës i ngritur në Kuvendin e Shqipërisë, keni një tabelë, e cila do t'ju ndihmojë për të kuptuar si ishte projekti i përcjellë në momentin e parë dhe cilat janë ndryshimet që ka vendosur në të grupi i punës. Keni edhe një letër dërguar nga një grup oficerësh të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe prokuroria e rrethit Tiranë, të cilët ngrenë një problem lidhur me pagesën që duhet të kenë oficerë e Policisë Gjyqësore ose më saktë raportin e pagesës së pagës së oficerëve të Policisë Gjyqësore në raport me prokurorinë. Ligji aktual për "Për funksionimin e Policisë Gjyqësore" parashikon se raporti i pagës së oficerit të Policisë Gjyqësore/ prokuror të jetë në masën 70%. Pra, nëse një prokuror paguhet mbi pagën e prokurorit, 70% e asaj page është paga e oficerit të Policisë Gjyqësore. Meqenëse ka pasur një debat në Kuvendin e Shqipërisë për raportet e pagesës, oficerët e Policisë Gjyqësore i kanë drejtuar një letër, sipas asaj që më referohet kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Taulant Balla, kryetarit të Komisionit të Ligjeve, zotit Ulsi Manja dhe një letër na është drejtuar edhe neve, përkatësisht në cilësinë e kryetares kjo letër më është drejtuar mua. Në letrat tuaja do të gjeni edhe një mendim, opinion fillestar për projektligjin, mendim i dhënë nga Prokuroria e Përgjithshme. Që në momentin e parë që u paraqit projekti ne i kemi kërkuar një opinion kësaj të fundit. Të gjitha këto dokumente besoj se mund të ndihmojnë punën e këtij komisioni për të reflektuar më mirë edhe pse ne jemi një komision për dhënie mendimi dhe jo komision përgjegjës, kjo nuk do të thotë se ajo çfarë mendojmë rreth projektit nuk vlen, sepse vlen puna e të gjithë kolegëve.

Komisioni i Ligjeve është duke pritur vendimmarrjen tonë, në mënyrë që të procedojnë me diskutimin nen për nen, të cilin tashmë e ka filluar. Këtu ishte e nevojshme për të kuptuar se në çfarë faze jemi në raport me projektin.

Zonja Hysi, ju falënderoj për prezencën!

Fjala është për ju.

Vaislika Hysi – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë dhe kolege, anëtarë të këtij komisioni,

Ashtu siç e tha me të drejtë kryetarja e Komisionit ky projektligj është prezantuar para komisioni tuaj, por në praktikën e mirë të punës që ka Kuvendi i Shqipërisë për të bërë konsultimin publik të një nisme ligjore të depozituar, projektligji i është nënshtruar një diskutimi të gjerë dhe konsultimi me një sërë institucionesh, së pari me përfaqësues të Policisë Gjyqësore, me Prokurorinë e Përgjithshme, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me misionin e OSBE-së në Tiranë, me misionin EURALIUS, por njëkohësisht kanë qenë edhe përfaqësues të Ministrisë së Financave. Me të drejtë zonja Felaj e tha se një nga pikat e forta dhe të debatueshme është trajtimi financiar i oficerëve të Policisë Gjyqësore, duke pasur parasysh se me paketën e re të ligjeve të reformës në drejtësi, këta të fundit nuk kanë më mundësi të promovohen dhe të bëhen prokurorë pa pasur kualifikimet në Shkollën e Magjistraturës. Grupi teknik i punës i ngritur pranë Komisionit të Ligjeve është kryesuar nga dy relatorët, deputetja Elena Xhina dhe Alket Hyseni. Ka pasur edhe përfaqësues nga të gjitha institucionet që sapa përmenda.

Besoj se ju është vënë në dispozicion përmbajtja e projektligjit të depozituar me firmën time, që për transparencë do ta theksoja edhe një herë nuk është nisma ime ligjore, por është një nismë e përgatitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të latë të Komisionit të Reformës në Drejtësi, e cila pas mbylljes së mandatit të këtij komisioni, iu kalua Komisionit të Ligjeve. Ju e dini se nismat në bazë të Kushtetutës mund t'i paraqesë një deputet, 20 mijë zgjedhës ose Këshilli i Ministrave. Në rastin konkret meqenëse reforma në drejtësi u ndërmor nga Kuvendi i Shqipërisë, ky projektligj është depozituar me firmën time.

Në diskutimin e këtij projektligji do të doja të merrnit në konsideratë, së pari Dokumentin Analitik të Sistemit të Drejtësisë, i cili ka renditur një sërë dobësish dhe problematikash me të cilat përballlet shërbimi i Policisë Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

Së dyti, objektivat që ka miratuar, janë miratuar në Dokumentin Strategjik për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

Të gjitha ndryshimet që janë bërë nga grupi i punës kanë mbajtur në konsideratë problematikat dhe objektivat. Ju jeni një komision shumë i rëndësishëm, jo thjesht pse jeni komision që jepni mendim, por dhe sepse përbëheni nga profesionistë, të cilët kanë punuar dhe e njohin shumë mirë Policinë e Shtetit, prokurorinë. Ju njihni shumë mirë problematikat ose marrëdhëniet midis prokurorisë e Policisë së Shtetit dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore, pozitën aspak të qartë që kanë pasur shërbimet dhe seksionet e Policisë Gjyqësore, respektivisht pranë Policisë së Shtetit dhe pranë Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë.

Unë do të flas në përgjithësi për procese dhe ndryshime, e më pas do të doja ndihmën e koleges Xhina, për të dhënë sqarime konkrete në lidhje me pyetje të veçanta, sepse ndoshta mund të ndajmë mes nesh mendime dhe qëndrime të ndryshme për dispozita apo rregulla të veçanta.

Objektivi i parë dhe kryesor që projektligji synon, është që të riorganizojë nga pikëpamja strukturore dhe funksionale ligjin e Policisë Gjyqësore. Kjo është bërë duke pasur parasysh ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, miratuar në marsin e 2017-ës. Kjo është edhe një nga arsyet se përse ky projektligj ka marrë kaq shumë kohë dhe nuk ka kaluar në vitin 2017 së bashku me paketën e ligjeve të tjera të reformës në drejtësi.

Pra, duhej të miratohej Kodi i Procedurës Penale, të ngrihej KLP-ja e KLGJ-ja, më pas të vazhdohej me miratimin e dy-tre ligjeve që kanë mbetur.

Në këtë kuadër, ndryshimet e sjella nga grupi i punës kanë bërë ndryshime shumë esenciale në organizimin dhe funksionimin e organit të shërbimit të Policisë Gjyqësore. Ndryshimet këtu kanë të bëjnë jo thjesht me emërtime, por edhe me mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre, qoftë të shërbimeve, ashtu edhe të seksioneve.

E dyta, lidhur me organizimin dhe funksionimin ka një qartësim sa i përket varësisë së këtyre institucioneve, grupi i punës, sidomos me mendimet e sugjerimet hera-herës kontradiktore midis përfaqësuesve të Policisë së Shtetit dhe përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme kanë sjellë disa riformulime në lidhje me varësinë dhe ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore, me organizimin e këtyre shërbimeve, me mënyrën e emërimit, transferimit, promovimit në karrierë të oficerëve të Policisë Gjyqësore, të shërbimeve e të seksioneve.

Një çështje tjetër me rëndësi, për të cilën do të doja t'ju tërhiqja vëmendjen, të nderuar kolegë, e që ia vlen ta diskutoni, është: cili do të jetë organi që do të vendosë për rekrutimin, procedimin disiplinor, transferimin, uljen në detyrë, pezullimin?

Në nismën që unë kam depozituar në emër të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë ka qenë parashikuar Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Pra, Komisioni i Policisë Gjyqësore ngrihej pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky Komision i Policisë Gjyqësore përbëhej nga prokurorë, anëtarë joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe nga anëtarë që caktoheshin nga drejtori i Policisë së Shtetit.

Ka pasur një debat të madh, dhe është neni 9 i projektligjit. Gjatë diskutimeve, grupi i punës u ka sjellë përpara një formulim të ri, që Komisioni i Policisë Gjyqësore nuk do të jetë më një organ, i cili krijohet pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por është një komision, një organ kolegjal, i cili do të ketë një përbërje të ndryshme nga ajo që keni në nismën e depozituar: pra, nga një prokuror që propozohet nga Prokurori i Përgjithshëm, nga një anëtar-oficer i Policisë Gjyqësore, i seksionit të prokurorisë, i cili përsëri propozohet nga Prokurori i Përgjithshëm, si dhe nga një anëtar nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, i cili caktohet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, një anëtar tjetër caktohet nga shërbimet e tjera, që mund të jenë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo institucione të tjera, me rotacion, si dhe një anëtar që është drejtues i strukturave hetimore të Shërbimit të Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, grupi i punës ka përcaktuar dhe sjellë kriteret që duhet të përmbushin, kushtet formalo-ligjore që duhet të përmbushin anëtarët e këtij komisioni.

E theksova këtë komision, pasi ky është ndryshimi më i rëndësishëm që vjen në raport me nismën që ne kemi depozituar, por edhe për shkak të funksioneve shumë të rëndësishme ose të kompetencave që ky Komision i Policisë Gjyqësore ka, pasi ai emëron, ngre në detyrë, transferon dhe komandon oficerët e Policisë Gjyqësore, shqyrton kërkesat e procedimit disiplinor, bën vlerësimin e punës dhe të integritetit të tyre.

Një gjë do të doja t'ju theksoja që në fillim, të nderuar kolegë, lidhur me oficerët e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit: ata nuk rregullohen nga ky ligj. Ata rregullohen në bazë të ligjit të posaçëm, që kemi krijuar për SPAK-un, që besoj se të gjithë e kemi parasysh. Pra, ka një ligj të posaçëm për Prokurorinë e Posaçme e për Byronë Kombëtare të Hetimit. Në këtë kuadër, ky Komision i Policisë Gjyqësore nuk ushtron kompetenca ndaj punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kanë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore.

Me të drejtë, kryetarja e komisionit theksoi një moment tjetër të shumë të rëndësishëm në këtë ligj. Ne kemi pasur një problem me Policinë Gjyqësore. Nuk dua të fyej asnjë nga kolegët që kanë ushtruar detyra drejtuese në Policinë e Shtetit, në prokurori apo në Policinë Gjyqësore. Hetimet proaktive kanë munguar ose kanë qenë të pakta. Ky ligj i ri synon të nxisë hetimet proaktive, profesionale dhe efikase, të ndërmarra nga Policia Gjyqësore, çka tregon se punonjësit e policisë, të cilët do të punojnë edhe në shërbime edhe në seksione, duhet të punësohen në bazë të një procedure transparente, publike, bazuar në profesionalizmin, në sistemin e hierarkisë së vlerave, në rritjen e tyre në karrierë, në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të meritokracisë.

Besoj se biem të gjithë dakord në lidhje me dëmin e madh që kemi bërë ne në 2010-ën, pavarësisht se maxhoranca jonë nuk i ka miratuar këto ndryshime, kur u hoq procedura e konkurrimit për oficerët e Policisë Gjyqësore dhe të shërbimeve, në seksionet e prokurorisë, dhe mund të behej oficer i Policisë Gjyqësore kushdo.

Pikërisht ky gabim i bërë në vitin 2010 riparohet tashmë, sepse si në nismën e depozituar, ashtu edhe një përmirësimet që ka bërë grupi i punës, projektligji sjell rregulla të qarta të emërimit, transferimit, promovimit në karrierë, duke vlerësuar gjithmonë burimet e brendshme, njerëzit që kanë dhënë kontribute në shërbimet apo në seksionet e Policisë Gjyqësore.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, është bërë një qartësim i rolit të prokurorit dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore. Prokurori do të jetë ai që do të ndjekë, do të mbikëqyrë hetimet, ndërsa oficerët e Policisë Gjyqësore kanë një sërë kompetencash të mirëpërcaktuara.

Kam një kërkesë për ju, të nderuar kolegë! Ky ligj ka lidhje edhe me ligjin “Për Policinë e Shtetit”, pra nuk ka lidhje vetëm me Kodin e Procedurës Penale, prandaj në diskutimin nën për nën të këtij ligji do të kërkoja vëmendjen tuaj, për të parë se si qëndron ligji i Policisë Gjyqësore, qoftë nisma e depozituar nga ana ime apo ndryshimet që ka bërë grupi i punës në lidhje me ligjin “Për Policinë Gjyqësore”. Janë ligje të të njëjtit nivel, janë ligje që miratohen me shumicë të thjeshtë, por nuk do të doja që Kuvendi i Shqipërisë të miratonte një ligj, nën të cilit mund të bien ndesh me nën të një ligji tjetër, siç mund të jetë ligji “Për Policinë e Shtetit”.

Nëse gjatë vlerësimit nën për nën ju konstatojnë përplasje të neneve, do të ishte shumë e rekomandueshme, si një komision shumë profesional që jeni, i përbërë nga profesionistë të fushës, të bëni rekomandimet përkatëse për amendamente të ligjit, nëse ju vlerësoni se ka nevojë për t’u amenduar ligji “Për Policinë e Shtetit”, me qëllim që të dyja

ligjet të jenë në harmoni, mbi të gjitha në harmoni me Kushtetutën, në harmoni me Kodin e Procedurës Penale, dhe ajo më e rëndësishmja është analiza që ne i kemi bërë sistemit të reformës në drejtësi, pra dokumentit analitik dhe planit të veprimit. Ne nuk mund ta anashkalojmë këtë dokument, i cili tashmë është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me votat e maxhorancës e të opozitës, pra kanë pasur një konsensus të gjerë.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, projektligji përcakton kritere të qarta për mënyrën e përzgjedhjes së oficerëve të shërbimeve dhe oficerëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore pranë prokurorisë. Është proces i hapur dhe transparent. Në projektligjin që kam depozituar në komision, përcaktohej qartë se çfarë do të thotë procedurë e hapur dhe transparente. Grupi i punës e ka hequr duke argumentuar që rregullat duhen përcaktuar në aktet nënligjore dhe unë mbështes fort mendimin që rregullat e lojës duhet të jenë në ligj dhe jo në akte nënligjore. Standardet sesi duhet bërë procedura e rekrutimit të personave, rregullat dhe kriteret e përgjithshme duhet të jenë të sanksionuara në ligj. Në çdo kohë mund të ndërrojnë titullarët e institucioneve, por nuk mund të ndryshojnë rregullat bazë të procesit të hapur dhe transparent të aplikimit për oficerë në shërbimet apo seksionet e Policisë Gjyqësore.

Të nderuar kolegë, ju kërkoj që përcaktimet e bëra në nenin 2 të këtij projektligji, pika 18, germa “e” duhet të jenë në ligj dhe të mos rregullohen më pas me akte nënligjore sipas titullarëve që mund të emërohen në drejtimin e këtyre shërbimeve.

Pika tjetër lidhet me ngritjen në karrierë, domethënë heqjen dorë, zëvendësimin, ngritjen në karrierë, transferimin e oficerëve të shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore.

Për herë të parë, falë edhe mbështetjes që na dha misioni EURALIUS dhe praktikës së mirë që ne kemi në ligjet e reformës në drejtësi, këto rregulla janë të mirëpërcaktuara në projektligj dhe secili nga punonjësit e Policisë Gjyqësore përpara se të bëjë kërkesë njeh se cilat do të jenë kriteret, kur mund të bëhet transferimi, komandimi, lirimi apo shkarkimi dhe në cilat raste nuk bëhet. Pra, ka një transparencë. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh kriteret e këtij ligji, por edhe Kodi i Procedurave Administrative.

Për sa i përket një risie tjetër në projektligj, që me të drejtë grupi i punës e ka lënë, është shmangia e konfliktit të interesit.

Të nderuar kolegë, ky është një problem i madh në funksionimin e shumë institucioneve, ku në këtë projektligj i është dhënë rëndësi mundësisë së shmangies së konfliktit të interesit dhe mundësive që ka për të komanduar një oficer i Policisë Gjyqësore të

një shërbimi ose të një seksioni për të kryer veprime hetimore për një çështje të caktuar dhe një shërbim të caktuar, gjithmonë në interes të punës dhe shmangies së konfliktit të interesit.

Pika e fundit është trajtimi financiar i Policisë Gjyqësore. Është shumë e drejtë ajo që tha zonja Felaj që ka pasur një debat gati për 1 vit e gjysmë për pagat dhe shpërblimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore. Ju e dini që ky është një projektligj me nismë deputeti dhe si rregull, në bazë të Kushtetutës, Ministria e Financave duhet të shprehet. Ministria e Financave ka rekomanduar që paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve të jetë 50% e pagës së prokurorit, por oficerët e Policisë Gjyqësore dhe të Prokurorisë së Përgjithshme kanë kërkuar 70%. Pra kemi dy alternativa. Punonjësit e praktikës, të zotët e punës, kërkojnë 70% të pagës së prokurorit, ndërsa Ministria e Financave thotë që të jetë 50% dhe për këtë ka pasur argumente pro dhe kundër. Argumentet pro Ministrisë së Financave kanë qenë të tilla, sepse ju e dini që paga e prokurorëve është më e lartë edhe se paga e funksionarëve të lartë të shtetit, ku një prokuror merr një pagë shumë më të lartë se Kryeministri, se ministrat dhe se deputetët. Pra, hierarkia e pagave në Republikën e Shqipërisë është prishur. Ju e dini që sot gjyqtarët kanë rrogë shumë më të lartë se edhe Presidenti i Republikës dhe ky ndryshim u bë me qëllim për të krijuar një sistem gjyqësor, i cili do të mund të punojë në mënyrë të pavarur, të mos korruptohet dhe, meqenëse paga mbahet si një nga elementet që ka ndikuar, megjithëse unë mendoj ndryshe, në nivelin e korrupsionit, me të drejtë ne kemi miratuar një sistem pagash, i cili tejkalon hierarkinë e pagave në Republikën e Shqipërisë. Ministria e Financave thotë që referimi 70% e pagës së prokurorit, me pagat e reja që kanë sot prokurorët, si ata që janë vlerësuar dhe ata që nuk janë rivlerësuar, është një disbalancim shumë i madh dhe krijon një nivel pagash shumë më të larta për oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve të seksioneve, se shumë struktura të tjera të nivelit të lartë në administratën shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, Prokuroria e Përgjithshme dhe oficerët e policisë, pa dyshim, i kanë qëndruar strikt propozimit që paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve duhet të jetë 70% e pagës së prokurorit. Grupi i punës ka sjellë një riformulim, ku në nenin 30 do të shikoni që pagat e oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve të prokurorisë, të gjykatës së shkallës së parë, të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme e kanë të llogaritur 50% të pagës bruto fillestare të prokurorit, i cili ushtron funksionet pranë tyre, por njëkohësisht ata do të kenë edhe një shtesë prej 2% në vit pas 5 vjetësh shërbim për çdo vit vjetërsie deri në 25 vjet. Pra, është përdorur, pak a shumë, modeli i pagës së prokurorëve dhe gjyqtarëve. Është bërë një diferencim për oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit, të cilët do të përfitojnë një pagë shtesë

deri në 10% të pagës bazë për gradën përkatëse, ndërsa për sa i përket pagë së oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit ajo është 20% më e lartë se paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve.

Të nderuar kolegë, mos harroni që pagat e SPAK-ut i kemi përcaktuar në ligj. Në qoftë se nëpërmjet ligjit të Policisë Gjyqësore do të bëhet një rritje e madhe e pagave, pagat e oficerëve të Policisë Gjyqësore do të dilnin më të larta se pagat e oficerëve të Policisë Gjyqësore të SPAK-ut, ku SPAK-u vetë do të hetojë krime me rrezikshmëri shumë më të lartë shoqërore dhe subjekte të posaçme. Ndaj, të nderuar kolegë, pavarësisht ndjeshmërisë dhe dëshirave që kemi, sepse edhe unë dua që çdo oficer të marrë pagën më të lartë, mbani në konsideratë edhe ligjet që janë miratuar në raport me Byronë Kombëtare të Hetimit dhe Prokurorinë Poasçme, me qëllim që të mos krijojmë një disbalancim. Në këtë kuadër, ju jeni më profesionistë dhe mund të shikoni hap pas hapi të gjitha këto nene, sidomos nenet 30 dhe 31.

Lidhur me përgjegjësinë disiplinore, ka një rregullim shumë të detajuar të procedurës së përgjegjësisë disiplinore të oficerëve të Policisë Gjyqësore të masave, duke bërë përshkallëzimin e tyre në bazë të rëndesës së që kanë, por edhe proporcionalitetin e masave disiplinore që mund të zbatohen në raport me rëndesën e shkeljeve të lehta, të rënda dhe shkelje shumë të rënda. Kjo ishte në përgjithësi ajo që unë doja të thosha, të nderuar kolegë.

Po të shikoni në tabelë, nisma e propozuar nga unë në emër të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë dhe nisma e amenduar nga grupi i punës paraqet shumë ndryshime. Në fakt, disa prej tyre janë thelbësore, ndërsa të tjerat janë të teknikës legjislative, janë riformulime dhe risaktësime të terminologjisë. Megjithatë, mendoj se në Komisionin e Ligjeve, ku unë jam anëtare bashkë me zonjën Xhina, do të jemi shumë të vëmendshme për të vlerësuar të gjitha sugjerimet tuaja.

Më lejoni t'ju falënderoj, meqenëse nuk kam pasur mundësi t'ju falënderoj më parë, për të gjitha projektligjet që ju keni pasur si komision për dhënie mendimi, për mendimet shumë profesionale që keni dhënë në disa nisma që kemi shqyrtuar dhe kemi miratuar në Komisionin e Ligjeve, ku edhe për këtë ligj do të jemi shumë të vëmendshëm për të adresuar të gjitha komentet, sugjerimet dhe propozimet tuaja.

Faleminderit!

Ermonela Felaj –Faleminderit, zonja Hysi!

Unë besoj se fjala juaj u solli edhe një herë në vëmendje kolegëve se cilat janë pikat më të diskutuara të projektligjit në fjalë. Është e vërtetë ajo që ju sapo thatë. Fatmirësisht ky komision ka në përbërje anëtarë, të cilët kanë pasur të bëjnë drejtpërsëdrejti me Policinë Gjyqësore, qoftë nga roli i atij që e delegon dhe e urdhëron Policinë Gjyqësore, por qoftë edhe nga drejtuesit e shërbimeve të policisë, që po ashtu edhe ato kanë të tilla raporte me shërbimet e Policisë Gjyqësore. Kështu që në këtë pikë dua të them se eksperiencia teorike, pa dyshim, është e vlefshme, por jo më pak është e vlefshme edhe ajo praktike, sepse besoj se është qartë për të gjithë që ne kemi një përvojë jo të vogël me Policinë Gjyqësore, kemi një përvojë që nga viti 1995. Ligji që ka pasur të bëjë me organizimin e kësaj strukture, në kohë të ndryshme ka pësuar ndryshime, me të cilat mund të kemi qenë ose jo dakord, por ama në fund të ditës puna na ka bërë që të dalim në konkluzionet se këto ndryshime e kanë impaktuar për mirë punën e Policisë Gjyqësore, apo për keq?

Besoj se në këtë komision askush nuk e vë në dyshim se puna e Policisë Gjyqësore është zemra e hetimit, sepse shumica dërmuese e veprimeve hetimore janë veprime që kryhen nga oficerët e Policisë Gjyqësore. Kështu që ne duhet t'i japim rëndësinë që i takon kësaj strukture, ta respektojmë për punën që bën dhe ta vendosim në ato nivele që ajo të performojë sa më mirë të jetë e mundur. Besoj se ky është momenti që e vendos këtë gjë.

Përpara se t'i ftoj kolegët, në fakt, dua të kemi mendimin e të dy prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme. Personalisht unë i njoh dhe e di që kanë një përvojë shumë të gjatë në sistemin e drejtësisë dhe mund të na ndihmojnë me qëndrimin e tyre për projektin e sjellë nga grupi i punës, për të cilin edhe zonja Hysi, me të drejtë, tha se ka sjellë ndryshime, që ishin të domosdoshme, sepse ligji në fund të ditës duhet të jetë i qartë, duhet të jetë me një gjuhë të thjeshtë, me një gjuhë të pastër, e cila nuk lë vend për dykuptueshmëri, por qartëson saktësisht se cili do të jetë pozicioni i oficerit të Policisë Gjyqësore, cili do të jetë trajtimi financiar i tyre, cila do të jetë karriera e tyre. Në fakt, këtu do të rezervohesha ta quaja një karrierë të mirëfilltë, sepse me ndryshimet që janë bërë në Kushtetutë oficerëve të Policisë Gjyqësore, nuk u lejohet më të bëhen prokurorë. Më parë oficerët e Policisë Gjyqësore kishin të drejtë të bëheshin prokurorë, pas një stazhi të caktuar pune, kurse tani rruga e ngritjes në karrierë është mbyllur, sepse prokuror bëhesh vetëm nëse ke mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Sidoqoftë, në këto rrethana bëhet akoma edhe më e domosdoshme që ta shikojmë siç duhet pozitën e oficerit të Policisë Gjyqësore.

Nuk e di, kush nga ju të dy e do fjalën, zoti Luli apo zoti Progonati?

Urdhëroni, zoti Luli!

Kujtim Luli – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për ftesën në komision për të dhënë edhe Prokuroria e Përgjithshme, komentet dhe sugjerimet në lidhje me përmirësimet e mundshme të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”! Ne jemi shprehur dhe shprehemi dakord në parim me projektligjin, për rëndësinë e tij, pa përsëritur asnjë gjë, siç tha edhe firmëtarja zonja Hysi. Pra, jemi dakord në parim për miratimin e këtij ligji. Është një ligj i domosdoshëm për të ndryshuar veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si themeli i veprimtarisë së një procedimi penal në sistemin e drejtësisë penale.

Ne të gjithë jemi koshientë për problematikat që kanë pasur, është një ndër hallkat që, në këndvështrimin e prokurorisë, ne e konsiderojmë si një hallkë të dobët në sistemin e drejtësisë penale. Është e domosdoshme rritja e cilësisë, veçanërisht profesionalizmi në ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore, ne i duam më afër zbatimit të Kodit të Procedurës Penale të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Ky është një ndër defektet e tyre, që e ka çuar veprimtarinë edhe në pavlefshmëri të akteve dhe të çështjeve shumë të rëndësishme, deri në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kështu që ligji ka zgjidhur atë që ne vlerësojmë të nevojshme dhe të domosdoshme, pra strukturimin e veprimtarisë së Policisë Gjyqësore dhe Policisë së Shtetit, që është një ndër subjektet që mban peshën më të madhe në veprimtarinë e Policisë Gjyqësore dhe në të gjithë sistemin e drejtësisë penale. Strukturimi i veprimtarisë së Policisë Gjyqësore në strukturat e posaçme do të çojë në rritjen e profesionalizmit të tyre dhe do të çojë në një veprimtari më profesionale të Policisë Gjyqësore dhe Policisë së Shtetit. Ajo çka bëhet nga të gjithë ato që kishin atributet e Policisë Gjyqësore dhe që bëhet deri sot do të vendoset në korniza të një strukture, që do të përzgjidhen oficerët më profesionalë që janë më specialistë në zbatimin e Kodit të Procedurës Penale. Mendoj se vendosja në struktura mund të ishte një ndër gabimet që duhej rregulluar me kohë për të shmangur ato problematika që në këta 24 vjet, siç e thatë edhe ju, Policia Gjyqësore e ka pasur në veprimtarinë e saj.

Ne jemi përpjekur që të japim kontributin tonë në këndvështrimin e prokurorisë, në ndryshimet e projektligjit dhe kemi bërë propozime edhe për ndryshime teknike, që lidhen me teknikën legjislative, për ta përqasur në terminologji me Kodin e Procedurës Penale, por edhe aty ku ne e kemi çmuar dhe e çmojmë se është e domosdoshme prania e atyre rregullimeve ligjore, të harmonizuara me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Ato gjëra që ne kemi sugjeruar, i konstatojmë se janë rivendosur

në draft, pra gjërat që lidhen me rolin drejtues dhe urdhërues të drejtuesit të prokurorisë në raport me Policinë Gjyqësore, që ka në juridiksion; rolin drejtues dhe mbikëqyrës të Prokurorit të Përgjithshëm në sistemin e Prokurorisë me të drejtat e dhënies së udhëzimeve të përgjithshme ndaj Policisë Gjyqësore, ashtu siç jepen edhe ndaj prokurorëve, si dhe rolin e mbikëqyrjes dhe të fillimit të procedimit disiplinor ndaj Policisë Gjyqësore. Pra, edhe ato janë vendosur në projektligj.

Kemi pasur diskutime rreth pozicionit të Prokurorit të Përgjithshëm, që ligji e ngarkon për të raportuar edhe në Kuvend, në zbatimin e atyre detyrave që ka Prokurori i Përgjithshëm në bazë të nenit 38 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, që të jenë edhe pjesë e këtij rregullimi në ligj që të ketë mundësi prokurori të mbikëqyrë veprimtarinë dhe të marrë *feed back* për të raportuar në përmbushjen e atyre detyrave që ligji e ngarkon Prokurorin e Përgjithshëm. Kështu që edhe nga diskutimet me relatorët e Komisionit të Ligjeve konstatoj që edhe ato propozime që janë bërë në lidhje me nenin 9, pika 1, germa “b” të projektligjit për vendosjen e një përfaqësuesi të Prokurorit të Përgjithshëm në përbërjen e këtij komisioni vlerësoj se janë zgjidhur.

Në vlerësimin tim, por jo vetëm në vlerësim tim, lidhur me pagën, që është një element sensitiv për veprimtarinë të gjitha shërbimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilët këtu e mora vesh se paskan reaguuar në komision, unë konstatoj, referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, se drejta e këtij raporti është tashmë e fituar nga oficerët e Policisë Gjyqësore në raport me pagën e prokurorit. Kjo është një drejtë e fituar me ligj. Ata sot aktualisht marrin 70% të pagës së prokurorit. Më 1 janar të vitit 2019 paga e prokurorit është rritur, por ata aktualisht marrin 70% të pagës së prokurorit. Kjo është një e drejtë e fituar. Po t’u referohemi vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vendimit nr. 1 të vitit 2003 dhe vendimit nr. 9 të vitit 2007. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar ligje për mosrespektimin e të drejtës së fituar me ato ligje, të cilat i ka konsideruar antikushtetuese. Kështu që, në vlerësimin tim, pa bërë diskutime të tjera për motivimin, nevojat e motivimit të Policisë Gjyqësore, nuk duhet të harrojmë që Policia Gjyqësore është pjesë e sistemit dhe e reformës në sistemin e drejtësisë. Siç e tha edhe zonja Vasilika, nisma për këtë projektligj ka filluar në kuadër të kësaj reforme. Policia Gjyqësore është një subjekt shumë i rëndësishëm i Kodit të Procedurës Penale. Duke qenë se është subjekt i rëndësishëm i këtij Kodi, ajo është pjesë e sistemit dhe e reformës. Kështu, kjo e drejtë e fituar me përqindje duhet të përmbushet me ndryshimin e ligjit nga 50% në 70%, siç edhe ne e kemi propozuar zyrtarisht. Mund të

ketë shumë gjëra për të diskutuar. Nëse keni ndonjë pyetje apo koment, ne jemi të gatshëm për t'iu përgjigjur.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Luli!

Zoti Progonati, a keni për të shtuar diçka?

Alfred Progonati – Nuk kam gjë tjetër, sepse i diskutuam gjërat para se të vinim këtu, por e shikoj të nevojshme dhe i mëshoj faktit që duhet t'u mëshohet më shumë kompetencave dhe fushës së veprimit së strukturës së posaçme që do të krijohet për hetimin. Pra, duhet të saktësohet në ligj që kjo strukturë që do të krijohet, të mos kryejë asnjë veprimtari tjetër veç hetimit, sepse deri tani na ka ndodhur që oficerët e Policisë Gjyqësore, veç hetimit të procedimeve penale, angazhohen nga drejtuesit e policisë në detyra të tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me hetimin. Kjo ndikon negativisht edhe në hetim, sepse e konsideronin si parësore detyrën që jepte drejtuesi i policisë, sepse prej tij varej. Ndërsa detyrat që i jepte prokurori, i shihte si detyra të dorës së dytë. Kjo bënte që hetimi të ishte i mangët, i cekët dhe tej afateve. Mendoj se ligji është formuluar drejt dhe zgjidh problemet që kemi hasur në të kaluarën. Duhet të synojmë stabilitetin e kësaj strukture që të merret vetëm me hetimin, sepse kjo do të sjellë pastaj një hetim profesional dhe goditje të krimit.

Ermonela Felaj – Faleminderit edhe ju, zoti Progonati!

Është e qartë, nëse duam që kjo strukturë, siç është Policia Gjyqësore, të funksionojë ashtu siç duhet, siç parashikon edhe Kodi i Procedurës Penale, mandej edhe ligji i veçantë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në shkrimin e attributeve të tyre. Nga përvoja mund të pohoj të njëjtën gjë, pra që shpesh herë në punën e oficerit të Policisë Gjyqësore, veçanërisht atyre të ardhur nga shërbimet, ka pasur konfuzion për shkak të varësisë dyfishe. Ndërkohë që varësinë administrative vijojnë ta kenë nga Policia e Shtetit, për punën hetimore vareshin nga prokurori. Kjo ka sjellë edhe vonesa. Mendoj se saktësimi i faktit që kemi oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve që janë juristë, se kemi oficerë të shërbimeve që janë punonjës të Policisë së Shtetit, kemi agjentë si dhe punonjës të strukturave të tjera ligjzbatuese që marrin attribute të Policisë Gjyqësore, pra kanë të drejtë të kryejnë veprime njësoj si Policia Gjyqësore, do të na ndihmojë që çdonjëri të kuptojë limitet e punës së tij dhe cilat janë prioritetet e punës së tij. Panelin e kemi të plotë, kemi njerëz me eksperiencë teorike dhe praktike, kështu që do të ftoj kolegët për të ezauruar të gjitha pyetjet e mundshme para se të kalojmë në miratimin në parim të projektligjit. Natyrisht, kur të shkojmë nen për nen, do të kemi një rast tjetër për të sqaruar edhe momente më të veçanta.

Po, zoti Nderu.

Pjerin Ndreu – Faleminderit, zonja kryetare! Falënderoj zonjën Hysi dhe prokurorët për sqarimet që bënë!

Si ish-oficer i shërbimeve të Policisë Gjyqësore, por edhe si drejtues i atyre shërbimeve, më lejoni të bëj një koment, pastaj do të ngre edhe nja dy-tri çështje në formën e pyetjeve. Që ka një problematikë midis prokurorit, seksioneve të Policisë Gjyqësore dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore, kjo është e dukshme. Në Kodin e Procedurës Penale të vitit 1995 ideja ka qenë që shërbimet e Policisë Gjyqësore, seksionet e Policisë Gjyqësore dhe prokurori të jenë një. Pra, që nga marrja në dijeni e kryerjes së veprës penale, deri në dërgimin gjyq të jenë një. Duhet thënë se shërbimet e Policisë Gjyqësore në momentin e rekrutimit kanë qenë të papërgatitura për të përballuar fluksin e punës që kishin për shkak të veprimeve në vendngjarje. Duke qenë e papërgatitur, prokurorisë, në njëfarë mënyre, i ka interesuar kjo gjë dhe nuk ka bërë përpjekje që shërbimet e Policisë Gjyqësore, dhe ndoshta vazhdon të mos e bëjë, megjithëse situata është përmirësuar, të trajnohen në pikëpamje të përpilimit të akteve në vendngjarje gjatë hetimeve. Për të mos thënë edhe këtë tjetër, që shërbimet e Policisë Gjyqësore me seksionet Policisë Gjyqësore kanë qenë dy gjëra të ndara. Shërbimet e Policisë Gjyqësore janë vetëm për të bërë veprimet në vendngjarje, për të kaluar dokumentacionin në prokurori, për të marrë ndonjë çështje pa autor, se ato me autor i kanë marrë vetë seksionet dhe i kanë hetuar. Pra, vetë prokurori nuk e ka luajtur rolin sipas nenit 4 të ligjit të vjetër për Policinë Gjyqësore, ku, në fakt, Policia Gjyqësore është në varësi të prokurorit dhe natyrshëm që do të jetë në varësi të prokurorit, sepse kryen anën procedurale. Prokuroria vetë nuk e ka kryer detyrën dhe e ka lënë vetë të pastabilizuar harmonizimin e këtyre dhe nuk është faji i shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Në rastin e policisë normalisht që ka mangësi, por kjo ka qenë dhe mbetet detyrë e prokurorëve, sepse nuk mundet as shefi i komisariatit, as drejtori i policisë, sepse nuk kanë as nivel profesional, as nuk kanë njohuritë e duhura të Kodit të Procedurës Penale, as të mënyrës së përpilimit të akteve, as gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, as gjatë hetimeve, as ndonjë delegim tjetër që i bëhet nga prokuroria. Pra, është prokurori aksi, ku këto shërbime dhe seksione lëvizin. Mendoj se ky ka qenë defekt i sistemit. Prokurorët janë treguar të pandershëm në marrëdhënie me shërbimet e Policisë Gjyqësore. I kanë lënë ashtu, duke u deleguar vetëm çështje pa autor. Se si i janë konceptuar ndryshimet e reja të ligjit për Policinë Gjyqësore, duhet të shihen. A është ky një problem sipas jush, apo nuk është? Në qoftë se jemi përballë një problematike, siç e tha edhe zoti Luli, dhe ka të drejtë, në fakt, sepse kjo është hallka më e dobët, por jo për faj të policisë, dhe

unë jam dakord me prokurorin Progonati që thotë se përdorimi i këtyre shërbimeve në shërbime të tjera cenon cilësinë e punës, si do të zgjidhet kjo? Si është menduar zgjidhja? Sepse këtu ka dy autoritete, flas gjithnjë për shërbimet: është autoriteti i prokurorit, që është autoriteti më i fortë procedural, është edhe autoriteti i shefit të komisariatit apo i drejtorit të policisë, që është më i fortë administrativ.

Tani, si do të zgjidhet problemi, që këta jo vetëm të kryejnë detyrën, por të marrin edhe trajnimin e nevojshëm qoftë edhe në punë e sipër, qoftë edhe në seminare apo në tryeza të ndryshme, ku të fillojnë dhe të rrisin profesionalizmin, të rrisin cilësinë e punës? Por këtë mund ta bëjnë prokurorët, nuk duhet ta bëjë policia.

Domethënë, ky moment duhet të qartësohet, sepse nëse ky moment vazhdon të shkojë në vakum, unë mendoj se do të ketë problematikë të madhe. Prandaj unë pyes: a e mendoni se duhet cilësuar varësia dhe duhet të specifikohet më shumë detyrimi që kanë oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore ndaj prokurorit? Se cili do të jetë raporti i komunikimit të tyre me drejtuesit e policisë, ky mbetet një problem për t'u parë, sepse do të mbetemi përballë fenomenit, që e përmenda edhe më parë.

Si do të rekrutohen këto shërbime? Unë e pashë pak, aty është përsëri historia që duhet të merret miratim sa herë të lëvizin e të tjerë, por mendoj se duhet të jetë pak më agresive, më fanatik problemi, duke shkuar gjithnjë në logjikën e prokurorit Progonati, i cili thotë: “Nëse ne nuk i fokusojmë shërbimet, në kuptimin e lëvizjeve të pakontrolluara, të marrjes së njerëzve jashtë kriterëve apo edhe fokusimi realisht tek ato punë që i takojnë Policisë Gjyqësore, pra në qoftë se do t'u lëmë lirshmëri më shumë drejtorëve të policisë, atëherë do të krijohet një problem, që do të cenojë realisht hetimet. Ndaj si mendohet të zgjidhen këto aspekte?

Për sa i përket problemit të pagës, është një problematikë, për të cilën, po të pyesim Ministrinë e Financave, ajo nuk i jep lekë asnjërit. Mundësisht, nëse pyetet Ministria e Financave, nëse pyeten ekspertët, këtu duhet të prevalojë mendimi i ekspertëve dhe i atyre që punojnë në terren.

Unë nuk e quaj të arsyeshme që ne të vëmë ekuilibër ndërmjet asaj që thotë Ministria e Financave dhe asaj çfarë thonë ekspertët, sepse nuk diskutohet që oficerët e Policisë Gjyqësore do të jenë në 70%, madje nga volumi i punës që përballojnë oficerët e Policisë Gjyqësore, është ku e ku me strukturat e tjera. Kështu që nuk ka sens që ne t'i çojmë nën 50% as shërbimet, as seksionet dhe askënd. Se si rregullohen pastaj në raport me Byronë

Kombëtare të Hetimit, në kuptimin e punës ose të dinamikës së punës, mendoj se nuk ka ndonjë ndryshim esencial nga ngarkesa që marrin oficerët e Policisë Gjyqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta rrezikshmëria është më e madhe atje, por jo ngarkesa e punës, sepse krimet e përditshme kundër personit dhe ato kundër pasurisë janë në fluks më të madh. Ne kemi bërë statistika, ndaj themi se janë në fluks shumë më të madh. Për shembull, për vjedhjet në vendngjarje kryhen veprime hetimore pafund në ditë. Por të mos i ngatërrojmë. Dinamika është shumë më e madhe këtu, ndërsa aty është rrezikshmëria më e madhe për nga problematika e veprave penale që ndiqen. Prandaj, e përsëris, për sa u përket pagave, duhet zgjidhur me mendimin e ekspertëve dhe duhet të ngulim këmbë që të merret mendimi i tyre.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Besoj se kemi nevojë për një përgjigje nga ana e prokurorëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendoj se pyetja ishte për prokurorët.

Nëse projekti e zgjidh dualitetin e oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore, ligji i vitit 2010, në mos gabo, “Për Policinë Gjyqësore” ua kaloi gati 80% të hetimit oficerëve të shërbimeve, jo atyre të seksioneve. Pra, oficerët e seksioneve hetonin vetëm veprat penale që ndodhnin në trupën e Policisë së Shtetit, pra autorët e veprave penale ishin ndër ta dhe për shkak se kishin konflikt interesi nuk mund të hetonin vetë.

Gjithsesi, është moment i rëndësishëm, apo jo, sepse kemi kaluar eksperiencë të ndryshme dhe secila prej tyre mund të na ketë njohur me avantazhet dhe disavantazhet e veta në çdonjërin rast.

Mendoj se pyetja e zotit Ndreu është vërtet e rëndësishme për të tërhequr edhe opinionin tuaj.

Kujtim Luli – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen, dua të sqaroj se ligji ka përcaktuar, në nenet 24 dhe 25 të tij, kryerjen e veprimeve hetimore nga shërbimet e Policisë Gjyqësore dhe kryerjen e veprimeve hetimore nga seksionet e Policisë Gjyqësore, duke përcaktuar në mënyrë, po themi, të grupuar se çfarë detyrash kanë shërbimet, ku, si rregull, çështjet që referojnë te shërbimet duhet t’u shkojnë shërbimeve të Policisë Gjyqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kallëzimet penale, që merren nga prokurori, kallëzimet që bëhen nga nëpunësit publikë, që nuk kanë shërbime të Policisë Gjyqësore, si dhe rastet që i drejtohen prokurorisë ose fillohen kryesisht nga prokurori, janë çështje që do të ndiqen nga seksioni i Policisë Gjyqësore.

Ligji ka bërë edhe rregullime, po themi, të nevojave të domosdoshme kur ato mund të kryhen nga shërbimet në bashkëpunim me Policinë Gjyqësore (neni 26), ndërkohë kur natyra e hetimeve është e zgjeruar me përfshirje të grupeve të ndryshme të interesit, si subjekte në çështje konkrete, i ka përfshirë edhe shërbimet dhe seksionet e Policisë Gjyqësore.

Por duhet të ritheksoj diçka: vendosja e strukturave të posaçme dhe lënia e oficerëve të Policisë Gjyqësore vetëm me detyrën për të hetuar për çështjet që ngarkohen sipas ligjit dhe sipas delegimeve që u bëhen nga prokurori, dhe siç i përcakton neni 24 i këtij ligji, do të shmangë ato probleme që, në vlerësimin tim, deri tani kanë qenë për shkak të komandimeve, heqjes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për shembull, transferohej oficeri i Policisë Gjyqësore, e fuste dosjen në kasafortë, nuk i raportonte prokurorit, ikte në rrethin ku komandohej nga drejtuesit e tij, ndërkohë prokurori pyeste: ku është “çështja”? Këto janë problemet.

Duke qenë një strukturë kompakte, me specialistë drejt perfeksionit në zbatimin e Kodit të Procedurës Penale, kjo strukturë vetëm do të rritet dhe do të ketë impakt shumë pozitiv në hetimin e çështjeve që i ngarkon ligji dhe do t’i delegohen nga prokurorët.

U bë një pyetje lidhur me rritjen e aftësive profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Edhe këtë moment ligji e ka parashikuar, në mos gaboj, në nenet 16-17, ku përfshihen edhe nevojat për trajnimin fillestar që duhet të bëjnë para se të caktohen në këto struktura, qoftë në seksione ose në shërbime, ashtu edhe trajnimin vazhdues. Pra, njësoj si prokurorët, edhe oficerët e Policisë Gjyqësore do të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të rritet profesionalizmi i tyre në ushtrimin e funksioneve që u ngarkon ligji.

Ermonela Felaj – Zonja Hysi, kishit diçka për të shtuar?

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë dua të shtoj diçka në vazhdim të asaj që tha zoti Luli dhe të shqetësimit që me të drejtë ngriti zoti Ndreu.

Është e vërtetë, i nderuar koleg, që niveli i Policisë Gjyqësore në shërbime lë shumë për të dëshiruar, por unë e preka pak kur thashë se në vitin 2012 në parlament është bërë një

ndryshim i ligjit “Për Policinë Gjyqësore”, i cili hoqi kriterin e konkurrimit dhe kushdo, pa pasur asnjë kualifikim apo trajnim, mund të bëhej oficer i Policinë Gjyqësore pranë Policë së Shtetit. Ndërkohë, ju sjell në vëmendje Akademinë e Sigurisë, ku kushdo mund të bëhej oficer policie me kurse 6-mujore. Për të gjitha këto shqetësime, të cilat ju me të drejtë i ngritët, në praktikën e sotme, pavarësisht se ligji nuk është amenduar, Policia e Shtetit ka filluar të bëjë përmirësime shumë të ndjeshme, duke futur, në bazë të ligjit të ri të arsimit të lartë dhe ngritjes së Akademisë së Sigurisë, kriteret të reja dhe më të forta për përzgjedhjen, rekrutimin, formimin fillestar dhe vazhdues, si dhe vlerësimin e oficerëve të Policisë së Shtetit në përgjithësi dhe oficerëve të shërbimeve gjyqësore pranë Policisë së Shtetit në veçanti. Megjithatë, të gjitha shqetësimet tuaja në këtë projektligj janë adresuar nëpërmjet 4 shtyllave:

Shtylla e parë janë kriteret e qarta që duhet të përmbushë një oficer i shërbimeve apo i seksioneve të Policisë Gjyqësore. Po të shikoni kriteret, që me të drejtë zoti Luli i përmendi nenet 16 dhe 17, janë të përcaktuara në ligj dhe jo në akte nënligjore, ku si kriteret bazë janë: përvoja në punë në institucion, trajnimi fillestar për hetimin, formimet ose specializimet e veçanta, që duhet të ketë qoftë oficeri i shërbimeve, aq më shumë oficeri i Policisë Gjyqësore të seksionit.

Shtylla e dytë ligjore (më pas do të shikojmë se si do të zbatohet në praktikë) janë detyrimet që ka çdo oficer i Policisë Gjyqësore dhe çdo oficer i policisë së shërbimeve gjyqësore të seksioneve për të pasur trajnim vazhdues. Trajnimi vazhdues nuk bëhet më me kurse afatshkurtra, por janë trajnime të cilat hartohen nëpërmjet një kalendari, që krijon komisioni i Policisë Gjyqësore në bashkëpunim me Akademinë e Policisë, si dhe me institucionet e arsimit të lartë, ku mund të jenë shkolla brenda dhe jashtë vendit, fakultetet e drejtësisë, fakultetet jashtë vendit. Pra, janë institucione të tilla, që nuk lihen në dëshirën e drejtuesit të Akademisë apo të drejtuesit të komisionit të Policisë Gjyqësore se më kë do të bëjë marrëveshje, megjithëse ligji i arsimit të lartë i jep mundësi edhe Akademisë të ketë marrëveshje me institucione brenda dhe jashtë vendit.

Shtylla e tretë shumë e rëndësishme është vlerësimi i veprimtarisë së oficerëve të seksioneve dhe të shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Ky vlerësim i rezultateve të punës së tyre është një vlerësim periodik, që bëhet çdo vit nga drejtuesi i prokurorisë apo nga komisioni i Policisë Gjyqësore.

Kriteret e vlerësimit janë përcaktuara në ligj. Njëkohësisht ka disa tregues se si matet ky vlerësim çka deri më sot është rregulluar me urdhra dhe udhëzime. Jo pa qëllim unë e

thashë që kriteret, standardet, shtyllat e çdo procesi duhet të jenë në ligj, sepse në aktet nënligjore nuk duhet të jepen shumë detaje apo gjëra parimore.

Shtylla e katërt është komisioni i Policisë Gjyqësore. Në nismën që unë kam firmosur ka qenë një komisioni i ngritur nga KLP-ja, në rastin konkret grupi i punës ka sjellë komisionin e Policisë Gjyqësore. Përbërja e tij, mënyra se si vepron, rregullat e funksionimit të tij janë një garanci më shumë.

Së fundi, meqenëse u përmend puna e pagës, unë jam dakord që të paguhen sa më mirë, por kam detyrimin, si anëtare e Komisionit të Ligjeve, edhe në kuadër të një shqetësimi që ngrihet shpesh në komision, që në hierarkinë e pagave duhet të jemi të vëmendshëm. Vetë ne deputetët kur votojmë ligjet e prishim këtë hierarki dhe më pas jemi po ne që ankohemi dhe themi pse vartësi merr më shumë se eprori apo pse ne nuk kemi eprorë profesionistë e të tjerë.

Dinamika është e madhe te shërbimet e Policisë Gjyqësore, por nuk është njëlloj të hetosh një aksident, një rrahje, një fyerje, një shpifje apo një plagosje të lehtë me një grup të strukturuar kriminal, me akuza që mund të bëhen për funksionarë ose ish-funksionarë të nivelit të lartë. Kjo ishte ajo që unë solla në vëmendjen tuaj për ta parë me kujdes. Ju jeni profesionistë edhe të teorisë, edhe të praktikës, kështu që mendimi juaj do të vlerësohet. Mua më vjen mirë që këtu është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Zonja Hysi, besoj se ishit e qartë.

Vasilika Hysi – Unë, si propozuese, kam sjellë 70% dhe thashë që grupi i punës ka sjellë këtë gjë, ndaj vendoseni ju, sepse ju jeni komisioni për dhënie mendimi. Unë fjalën time nuk e kam në këtë komision, por e kam te komisioni ku jam anëtare.

Ermonela Felaj - Në fund të fundit, këtë gjë nuk e vendos një komision në veçanti dhe nuk e vendos një anëtare në veçanti, por e vendos Kuvendi i Shqipërisë. E rëndësishme është që ne të jemi sa më komplementarë me ligjin në rastin kur caktojmë këtë pikë, që të mos bëhet kjo si lojë e kungulleshkës. Ne duam që këta njerëz t'i trajtojmë si duhet, që të bëjnë punë e tyre.

Unë do t'i lejoj një koment zotit Ndreu, sepse jemi në diskutimin në parim të projektit. Më pas, me lejen e zotit Harusha, dua t'i jap fjalën zotit Sterkaj.

Pjerin Ndreu – Unë mendoj se duhet ta lemë çështjen e pagës, siç e tha edhe kryetarja, sepse është një çështje që do ta diskutojmë kur ta shqyrtojmë projektligjin nën për nen, por edhe në parlament. Pra, kjo është një çështje jashtë rendit të ditës së këtij komisioni.

Nëse do t'ia lemë Akademisë së Rendit atributin e shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Mund të them se Akademia nuk i ka kapacitetet për t'i trajnuar oficerët për veprimet hetimore. Kjo është pika e fillimit të çdo veprimi procedural, sepse nga pika e fillimit varet fati i mëtejshëm i hetimeve. Pra, gjithçka varet nga mënyra se si kontakton, si e merr kallëzimin, si i ndjek të dhënat specifike, që të çojnë drejt autorit, si i referon këto të dhëna, si e bën këqyrjen e vendit të ngjarjes, si e gjen dhe si e fikson.

Unë mendoj se prokurorët duhet të marrin situatën në dorë dhe të jenë pjesë e drejtimit të trajnimeve, që ndoshta, për shkak të qenies në polici mund të bëjnë në Akademi apo ku di unë, por prokurorët duhet të jenë aty. Prokuroria e Tiranës ishte e vetmja në Shqipëri që kishte një prokuror të gatshëm dhe për çdo ngjarje prokurori ishte aty. Çfarë bënte prokurori? Ai kualifikonte veprimet në vendin e ngjarjes, si dhe merrte pjesë në procesin e hartimit të të gjitha dokumenteve të tjera, deri në referim. Ne kur shkonim para prokurorit kishim shumë pak përplasje, sepse prokurori ishte vetë mbikëqyrësi i të gjitha veprimeve. Kjo metodë ka qenë shumë e mirë, duke pasur parasysh edhe autoritetin që ka për shkak të varësisë procedurale që ka Policia Gjyqësore. Pra, prokuroria nuk duhet të shmanget dhe nuk duhet të përsëritet loja që punë e madhe nëse i bëjnë apo jo veprimet mirë shërbimet. Unë mendoj se ky është thelbi se ku duhet të ndryshojë fizionomia e punës së Policisë Gjyqësore. Pra, ajo duhet të ngjizet me prokurorinë dhe ky është problemi. Prokuroria nuk duhet t'i konsiderojë si instrument shërbimet e Policisë Gjyqësore, por si pjesë të saj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu, për komentin!

Në fakt, në nenin 27 të ligjit bëhet fjalë për trajnimin fillestar për pranimin në Policinë Gjyqësore. Këtu ngarkohet jo vetëm Akademia e Sigurisë, por të gjitha institucionet publike arsimore, të cilat, në bashkëpunim me komisionin e Policisë Gjyqësore dhe Prokurorinë Përgjithshme, duhet organizojnë trajnimin e të gjithë oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Sigurisht, ajo që tha zoti Ndreu, ka vend të thuhet, sepse e dimë shumë mirë që hetimi ka veprime që konsiderohen të papërsëritshme. Pra, nëse nuk vëzhgohet mirë vendi i ngjarjes, nëse kontrollet nuk bëhen mirë në momentin më të parë, nëse nuk bëhen sekuestrimet në momentin më të parë dhe të tjera do të thotë që hetimi është cenuar, provat kanë rënë dhe ndoshta nuk rikuperohen dot më. Prandaj është e rëndësishme që oficerët, prokurorët dhe të gjithë aktorët e drejtësisë penale të jenë shumë mirë të orientuar me atë që hetimi kërkon.

Fjalën e ka zoti Harusha për pyetje.

Luan Harusha – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të them dy gjëra për oficerët e Policisë Gjyqësore. Unë nuk besoj se duhet të nxirren gjithë këto pretendime lidhur me pagën e OPGJ-ve, për shkak të ngarkesës së tyre profesionale. Ata janë mbështetja kryesore e prokurorit në zgjidhjen e çështjeve, mendoj se shumica e tyre ka mbi dhjetë vjet pune eksperiencë dhe janë hallka kryesore e sistemit të drejtësisë. E para.

E dyta, në këtë projektligj konstatohet që OPGJ-të e fillojnë dhe e mbarojnë karrierën si të tillë, prandaj mendoj se duhet të parashikohet në ligj që një OPGJ, që ka mbi 10 apo 15 vjet punë, i cili ka një vlerësim të mirë nga prokurori i rrethit, të ketë të drejtën të vazhdojë edhe magistraturën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por të kenë të drejtën të futen në konkurs.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E pengon ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë lidhje ka me mesataren një OPGJ, i cili ka 15 apo 20 vjet eksperiencë pune?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një student i sapo diplomuar nuk mund të krahasohet me një OPGJ, që ka 15 vjet eksperiencë pune. Unë mendoj që t'u jepet e drejta të futen në provim për magistraturë, si gjithë të tjerët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sipas këtij ligji, ata dalin pastaj të papunë, sepse vjen tjetri me magistraturë dhe me kriterë të reja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Më shumë se një pyetje ishte një sugjerim dhe një shqetësim i zotit Harusha.

Është e vërtetë që në sistem ka njerëz me përvojë të gjatë pune. Unë kam një listë të oficerëve të Policisë Gjyqësore, zoti Hysi dhe zoti Progonati mund të na e konfirmojnë, ku janë 37 vetë, të cilët kanë mbi 15 vjet pune në sistem, ndërkohë që janë pak më shumë se 130 oficerë të Policisë Gjyqësore në të gjithë Shqipërinë.

Unë personalisht do të bashkohesha me qëndrimin tuaj, në kuptimin që në një të ardhme duhet t'u hapim një derë oficerëve të Policisë Gjyqësore në sistem, siç kemi bërë gjithmonë, ku kemi marrë edhe njerëz të praktikës dhe i kemi bërë gjyqtarë dhe prokurorë.

Por besoj se duhet t'i japim pak më shumë kohë vetes për të parë se si funksionon, sepse ne kemi votuar për ndryshimet kushtetuese dhe në Kushtetutë kemi parashikuar që pjesë e prokurorisë dhe e gjykatave bëhen vetëm ata që kanë përfunduar shkollën. Në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk pengohet askush të vijojë Shkollën e Magjistraturës, por do t'u nënshtrohet rregullave që ka shkolla dhe këtu do të stoponim diskutimin.

Fjalën e ka zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit!

Së pari, zonja Hysi, në fjalën tuaj hyrëse thatë që nuk jeni hartuesja e këtij drafti. Pra, ju vini këtu për të përmbushur një akt formal ligjor që një deputet duhet të bëjë propozimin për të zëvendësuar 20 mijë zgjedhës apo qeverinë, që nuk e ka propozuar këtë projektligj.

Ju thatë që ky draft është hartuar nga Komisioni i Reformës në Drejtësi dhe është hedhur poshtë nga një grup pune.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e thonë këta. Unë këtu kam dy variante të draftit, varianti i parë me firmë të Ilir Metës dhe varianti i dytë “A” dhe “B”. Në 43 nenet që ka ligji, pothuajse 39 nene kanë ndryshuar. Dua të di kush ishin ata që e hartuan këtë draft dhe kush është ky grup pune, sepse ju nuk merrni përsipër të jeni hartuesja e draftit? Ju thoni: “Unë i bëj propozimin e këtij drafti Kuvendit, për të përmbushur aktin formal ligjor.” Pra, kush është ky grup pune që bën propozimin e variantit “B”? E para.

E dyta, megjithëse mora një përgjigje joshteruese nga kryetarja, dua të di sa është numri në total i OPGJ-ve në Shqipëri, i ndarë respektivisht në OPGJ shërbimesh, seksionesh dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit?

Prokurori Luli tha që nga 1 janari OPGJ-të marrin 70% të rrogës së prokurorëve, por kjo ka qenë parashikuar edhe nga Komisioni i Reformës në Drejtësi, pra shikoj që ky është ndryshim në nen, që nga 70% që ka hartuar komisioni me grupin e punës, është parashikuar që paga e OPGJ-ve të jetë 50% e rrogës së prokurorëve. Nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dua të di se sa ndikon ky 20% në buxhetin e shtetit brenda një viti, duke pasur parasysh numrin e OPGJ-ve?

Në një nen të këtij drafti thuhet: “Ngitja dhe ulja në detyrë”. Çfarë parashikon ngritja në detyrë e një OPGJ-je, meqenëse nuk bëhet prokuror? A kanë grada? Nëse po, çfarë gradash kanë, ushtarake apo të Policisë së Shtetit? Po flas për OPGJ-të e shërbimeve.

Po OPGJ-të e seksioneve çfarë gradash kanë? Ata që janë pranë prokurorive, nëse ngrihen në detyrë, çfarë bëhen?

OPGJ-të futen në punë dhe dalin në pension si të tillë. Me uljen në detyrë, kuptohet marrja e masave disiplinore, po me ngritjen në detyrë çfarë është parashikuar, sidomos për OPGJ-të e seksioneve?

Zonja Hysi ndoshta me të drejtë ishte këmbëngulëse për pagat, dua të di sa është paga e prokurorit? Sa është paga e OPGJ-ve dhe sa është e gjyqtarëve, sepse përpara syve të qytetarëve duket sikur ne jemi më të paguarit? Që ta dinë shqiptarët ne e kemi rrogën mujore 800 euro.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Duke i thënë njëri-tjetrit hajdut, ata kujtojnë se hajdutllikun e bëjmë me firmë në bordero dhe se zhvasim buxhetin. Prandaj dua të di sa është rroga e prokurorëve, që nga 1 janari i vitit 2019 dhe të bëjmë llogaritë e 70% të OPGJ-ve, që ta kujtojnë të gjithë?

Vasilika Hysi – Unë do t'i përgjigjem pyetjes që ka të bëjë me ndryshimet që ka pësuar nisma e propozuar, kush e ka hartuar dhe si ka ndryshuar.

Për sa i përket numrit të oficerëve të Policisë Gjyqësore në shërbime, në seksione dhe të tjera, mund të flasim përfaqësuesit e prokurorisë, këshilltarja dhe drejtoresha Juridike, zonja Arbi.

Në fakt, zoti Murrizi, reformën në drejtësi e ka ndërmarrë një komision *ad hoc*, i përbërë nga deputetë të maxhorancës dhe opozitës. Pranë këtij komisioni është ngritur edhe një grup i ekspertëve të nivelit të lartë, me përfaqësues nga institucione të ndryshme, nga Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Presidenti i Republikës, universitetet, Shkolla e Magjistraturës, madje ka edhe një sekretariat. Pra, ka qenë një grup i madh ekspertësh, nëse ju kujtohet, nuk i kanë shkruar deputetët, sepse pati një konsensus që të përgatiten nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë.

Jam absolutisht dakord me shqetësimin që ju ngritët që grupi i ekspertëve të nivelit të lartë të hartojë një projektligj, por komisioni e mbylli veprimtarinë tij në dhjetor të vitit 2016, ndërkohë që ligji për Policinë Gjyqësore nuk mund të miratohej para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, me mbylljen e veprimtarisë së komisionit *ad hoc*, i kaluan Komisionit të Ligjeve dhe ky proces u bë në mars të vitit 2017. Në varësi të ndryshimeve që pësoi Kodi i Procedurës Penale, detyrimisht do të ndryshonte edhe drafti i projektligjit për Policinë Gjyqësore, që kishte përgatitur grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, i cili përbëhej nga punonjës të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së

Përgjithshme, prokurorë, profesorë nga Shkolla e Magjistraturës, me sa mbaj mend unë, se, në fakt, ne kemi qenë vëzhgues dhe i është nënshtruar një sërë konsultimesh publike. Të gjithë oficerët e Policisë Gjyqësore na kanë shkruar ne, na kanë ngritur shqetësime, na kanë adresuar letra dhe rekomandime, madje janë dëgjuar edhe në seancat publike. Ky ligj ka marrë 3 vjet e gjysmë kohë për t'u diskutuar. A ka ndryshuar shumë? Po, ju keni të drejtë, ligji ka ndryshuar.

E thashë pak më parë në fjalën time, dhe po e përsëris, së pari, shumica e ndryshimeve janë diskutuar nga paketa e ligjeve që ne miratuam për kompetencat që i dhamë KLP-së dhe KLGJ-së. Së dyti, do të ndryshoj, sepse do të reflektonte ndryshimet e ligjit të SPAK-ut, që u miratua pasi komisioni e mbaroi funksionin e tij. Së treti, do të reflektonte të gjithë konsultimin publik, i cili ishte i gjerë. Shqetësimet që ngritën oficerët e Policisë Gjyqësore ishin të drejta. Unë them se ata nuk kanë më mundësi të bëjnë karrierë si prokurorë ose gjyqtarë, mbeten brenda...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për konsultimin publik janë grupet e interesit. Së katërti, një pjesë e ndryshimeve që ka bërë grupi i punës lidhen me të gjitha ligjet që janë miratuar. Pra, që nga momenti që është depozituar ligji dhe ligjet që janë miratuar më pas, që janë me 3/5-tat, duhej të ishin në harmoni. Ka një pikë që po diskutohet, zoti Murrizi, unë ua tërhoqa vëmendjen në mënyrë miqësore për të qenë të vëmendshëm, që ligji nuk duhet të ketë dispozita që bien ndesh me njëra-tjetrën. Së fundi, pjesa tjetër e ndryshimeve janë teknike legjislative. Nëse ndryshohen një ose dy nene që janë shumë të rëndësishme për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ato si efekt domino ndikojnë edhe në nenet e tjera. Me të drejtë ligji kishte nevojë për t'u qartësuar nga pikëpamja e gjuhës dhe teknikës, siç e tha kryetarja e komisionit.

Unë nuk kam marrë firmën e 20 mijë firmëtarëve. Kuvendi i jep të drejtë deputetit të firmosë të gjitha ligjet e reformës në drejtësi, të hartuara nga ekspertët e nivelit të lartë, të cilëve nuk iu njihet e drejta kushtetuese të propozojnë ligje. Pra, firmosen nga deputetë, ndaj unë jam shumë e hapur për ndryshime, sepse jam deputete dhe mendoj se ligji duhet të jetë shumë i qartë dhe të mos ketë keqkuptime.

Ermonela Felaj – Zoti Luli.

Kujtim Luli – Faleminderit!

Unë do t'iu përgjigjem disa pyetjeve, sepse kishte shumë pyetje, por nuk kanë lidhje me prokurorinë.

Unë mund t'ju them lidhur me pyetjet që u bënë për numrin e oficerëve të Policisë Gjyqësore. Mund t'ju them se Policia Gjyqësore është organizuar në seksione dhe shërbime. Në seksionet e Policisë Gjyqësore në sistemin e prokurorisë janë rreth 160-170, numrin e saktë mund t'ju sjell, sepse përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Këtu fillojnë seksionet e shërbimeve pranë prokurorive të rretheve gjyqësore, pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe në një seksion që është në Prokurorinë e Përgjithshme.

Sa u përket shërbimeve, numri i përgjithshëm i oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore është i lidhur me numrin e përgjithshëm që ka Policia e Shtetit, Policia Ushtarake, seksionet e hetimeve në Dogana dhe Tatime, në Pyjore dhe të gjitha institucionet që ligji iu atribuon funksionet e Policisë Gjyqësore. Në nenin 10 germa "a", ligji i ri parashikon mënyrën si do të caktohet numri i përgjithshëm, i cili vendoset në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm dhe ministrat përgjegjës, të cilët kanë në varësi Policinë Gjyqësore.

Duke strukturuar, do të shkojmë drejt profesionalizmit të Policisë Gjyqësore, ashtu siç e duam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne jemi 336 prokurorë, 2 prokurorë ka 1 oficer. Ky është numër shumë i ulët, por, kur e shikon në raport edhe me shërbimet pastaj numri rritet në raport me prokurorët.

Sa u përket gradave, oficerët e Policisë së Shtetit dhe oficerët e policisë së shërbimeve në Policinë Ushtarake...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve nuk kanë grada.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kanë ngritje në detyrë, vetëm nëse do të vijë nga seksioni pranë prokurorëve në Policinë Gjyqësore në shkallë të parë, mund të ngarkohen me detyra në Prokurorinë e Përgjithshme, por unë çmoj që duhen vendosur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shkon paga në raport me prokurorin pranë të cilit punon oficeri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vlerësimin tonë duhet të ketë oficerë të Policisë Gjyqësore edhe pranë Prokurorive të Apelit në shërbim të gjykatave dhe të prokurorive në Apel për të kryer detyrat që lidhen me njoftimet dhe me ekzekutimin e vendimeve me ekzekutim të menjëhershëm.

Myslim Murrizi – Sa është paga e tyre?

Kujtim Luli – Në lidhje me pagën, ka një formulë. Prokurori merr pagën referuese të drejtorit të Përgjithshëm në Kryeministri plus 90%-106%. Pra, 90 është prokurori i Prokurorisë së Shkallës së Parë, 106 është prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ky raport varion me 98 për prokurorin e Apelit. Pra, për të tria këto nivele shtohet 90-shi i pagës së grupit të Drejtorit të Drejtorisë dhe më pas vjen vjetërsia 2% për pagë, për prokurorët deri në 25 vjet.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Luli, më falni që po ju ndërpres, sepse ky është një moment teknik, prandaj për të qenë të drejtë ne, nesër, kur të fillojmë diskutimin nen për nen, mund të thërrasim zotin Luan Abazi, personin që e mbulon këtë punë në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili ka qenë gjithmonë prezent në Komisionin e Ligjeve për buxhetin dhe të marrim një opinion më të saktë.

Kujtim Luli – Kjo më shumë është problem formule...

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Këto gjëra mund t'i ballafaqojmë nesër...

(Diskutime pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Sa e kanë pagën prokurorët e Lushnjës?

Ermonela Felaj - Nesër do t'i shohim më saktë se sa lekë merrnin dhe sa do të marrin.

Myslim Murrizi – Nuk mund të më gjykosht ti mua...

(Diskutime pa mikrofon)

Po çohu e dil përjashta...

Ermonela Felaj – Kolegë, të lutem, evitoni debatet!

Ne duhej të ishim kujdesur më shumë...

Myslim Murrizi – Po deshe të dëgjosh mirë, por nuk deshe ja ku e ke derën.

Ermonela Felaj – Ndoshta materialet duhet t'i kishim marrë që sot, por megjithatë kemi kohë deri nesër për t'i parë, sepse nevojitet edhe një ballafaqim për këtë gjë.

Fjalën e ka zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Shumë gjëra u ezauruan dhe nuk dua t'i përsëris. E mbështes kolegun Ndreu, gjithashtu, edhe zotin Luan sa i përket 70%-it. Reformën në drejtësi të gjithë e kemi votuar me kënaqësi, madje kemi rrahur duart fuqishëm. Kjo reformë i përfshin të gjitha brenda ligjit, ndërsa tani dalin disa grupe të tjera si qëllimet, financat, kryesisht e kam

për relatorin, e cila do të na intimidojë që ne të pranojmë 50%-in. Unë si deputet i Komisionit të Sigurisë nuk dua të luaj me oficerët e Policisë Gjyqësore, hidhja sot e merrja nesër. Përderisa ata e kanë filluar me 70%, le të vazhdojnë me 70% të vlerës së rrogës në raport me rrogën e prokurorit. Në drejtësi bëhen analiza dhe krahasime të deputetit me prokurorin, por nëse duhet të luftojmë korrupsionin prokurori, nuk mund ta luftojmë atë nëse nuk paguhet.

Atëherë, oficeri i Policisë gjyqësore është bashkëpunëtori i prokurorit, i cili duhet të mbajë barrën më të madhe aktive se sa prokurori, sepse prokurori jep detyrat dhe ai e ndjek punën gjithandej. Ai nuk është pastrues i zyrës së prokurorit, por është punëtor shkencor i prokurorit që realizon hetimin e një çështjeje korruptive apo kriminale në të gjitha fushat nga më të voglat deri te më të mëdhatë.

Unë e mbështes me forcë këtë gjë dhe i propozoj Komisionit të Sigurisë që ne duhet të jemi dakord që 70%-shi të vazhdojë. Pra, përderisa rroga ka filluar me 70% dhe kjo është bërë me ligj, atëherë nuk ka asnjë grup pune që të dalë sipër kësaj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sterkaj!

Fjalën e ka zonja Dhima dhe më pas zoti Braho.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj kolegën Hysi për prezantimin, njëkohësisht edhe përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme!

Në vijim të fjalës së kolegëve dhe së fundmi të zotit Sterkaj, kam një pyetje. Cilat kanë qenë argumentet e paraqitura nga Ministria e Financave për ndryshimin e pagesës nga 70% në 50%, sepse kjo normalisht është një e drejtë e fituar? Në momentin kur është fituar nga ana e Ministrisë së Financave, është dhënë dakordësia për këtë lloj pagese.

Në nenin 30, megjithëse ne nesër do t'i kalojmë nen për nen, përveç kësaj pagese ka edhe pagesa të tjera. A është shprehur Ministria e Financave për këto përfitime që do t'i përfitojnë policët e Policisë Gjyqësore sipas këtij ligji?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zonja Dhima, për të qenë më korrektë, unë mund ta pyes zonjën Hysi, nëse në Komisionin e Ligeve është depozituar një mendim nga shkrim nga ana e Ministrisë së Financave dhe ta tërheqim pranë këtij komisioni. Në këtë mënyrë do të jemi më objektivë në dhënien e kësaj përgjigjeje, që të mos bëhen interpretime të natyrës individuale. Fakti që sot oficerët e Policisë Gjyqësore janë duke marrë 70% të rrogës së rritur të të gjithë

prokurorëve vjen për arsye se ligji e detyron Ministrinë e Financave, sepse në fuqi është ende ligji i vjetër në raport me draftin që kemi ne. Pra, për sa kohë që do të veprojë ky ligj, Ministria e Financave është e detyruar t'i paguajë me 70% të gjithë oficerët e Policisë Gjyqësore, ashtu siç po i paguan që nga 1 Janari 2019.

Ne do të tërheqim shkresën dhe nesër kur të fillojmë diskutimin nën për nën do t'i kemi të gjitha letrat përpara.

Fjalën e ka zoti Braho dhe më pas zoti Xhindi.

Spartak Braho – Zonja kryetare, mendoj se po bëjmë diçka shumë të mirë, duke ndryshuar ligjin për Policinë Gjyqësore. Ligjit të vitit 1995 i ka kaluar koha me gjithë ndryshimet që ka pësuar në vitin 2010. Personalisht do t'ju thosha se zbatimi i këtij ligji në një masë të konsiderueshme ka dështuar, ashtu siç ka dështuar dhe paraqitet mjaft problematike gjatë këtyre viteve jo vetëm puna e oficerëve të Policisë Gjyqësore në përgjithësi, por edhe e prokurorisë.

Prokuroria e ka konsideruar këtë mënyrë organizimi komoditet për veten e saj dhe nuk e ka çarë kokën ndonjëherë. Unë personalisht si deputet i vjetër i kam vajtur Arben Rakipit, Dhori Sallakut dhe u kam thënë: “Merreni dhe futeni nën sqetull Policinë Gjyqësore, sepse kështu siç është me ndryshimet që duhen parashikuar...”

Por nga ajo që unë shoh, edhe nga mënyra si është parashikuar, nuk merret vesh se kush do ta bëjë hetimin, kush do ta realizojë hetimin, kush do ta çojë deri në fund hetimin, për këtë arsye kam vetëm një propozim. Nuk e di nëse do të më dëgjoj zonja Hysi apo përfaqësuesit e prokurorisë, që asnjë veprim procedural që lidhet me kallëzimin apo vendin e ngjarjes të mos bëhet pa praninë e prokurorit, sepse ai duhet të jetë atje. Ne që kemi punuar në këto organe e dimë se çfarë do të thotë, gjë që e tha edhe kryetarja e komisionit, hetim, është vendi i ngjarjes. Pa praninë e prokurorit nuk duhet të kryhet asnjë hetim nga ana e Policisë Gjyqësore. Pra, ashtu siç shtrihet atje për të parë vendin e ngjarjes, për të parë viktimën apo vendin ku ka ndodhur vrasja, çfarë do t'i dalë përpara, do të vejë e do të shtrihet edhe te prokurori. Prokurorët janë bërë agallarë. Dikush në Komisionin e Ligjeve tha edhe një fjalë më të rëndë. Unë nuk dua ta përsëris, por në këtë mënyrë ne zgjidhim edhe atë shqetësim, të cilit i mëshoi fort edhe Pjerini, edhe shokët e tjerë.

Kam parasysh nën 5 “Funksionet e Policisë Gjyqësore”, jo për ta denigruar projektin, por ka vetëm fjalë. Ka vetëm fjalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka ndryshuar.

Pika “c” thotë: “Policia Gjyqësore kërkon autorët e veprave penale.” Çfarë do të thotë kjo? Asgjë. Këtu mund të gjendet vendi që asnjë veprim procedural të mos bëhet pa praninë e....

Këtu ka vetëm ujë dhe llafologji.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se do të na ndihmonte më shumë, që këtë përcaktim taksativ ta vendosnim në Kodin e Procedurës Penale, sesa te ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Gjithsesi, unë mendoj se dera nuk është fare e mbyllur, sepse Prokurori i Përgjithshëm me udhëzimet që jep, mund të detyrojë të gjithë sistemin që prokurori të jetë i pranishëm në vendngjarje, siç ka ndodhur më parë, kur për çdo lloj politike penale, që është bërë në sistemin e drejtësisë penale, Prokurori i Përgjithshëm ka vepruar nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve, që shpërndahen në të gjithë sistemin.

Fjalën e ka zoti Xhindi!

Nuk e di nëse ka kolegë të tjerë për të bërë pyetje, se më pas do të kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Anduel Xhindi – Faleminderit, kryetare!

Unë kisha 2 pyetje. E para: Sa e lehtëson OPGJ-në një prokuror me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet që për çdo vendim prokurori i drejtohet gjykatës? Nga ana tjetër, është përfshirë viktimat si subjekt procedure, që e komplikon procesin nga pikëpamja e akteve apo njoftimeve.

Pyetja e dytë: A ka mundësi avancimi në karrierë, sipas parashikimeve të këtij projektligji?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhindi!

Besoj se pyetjet janë për përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme. Besoj se do të përgjigjet zoti Luli, sepse ai ka qenë edhe në diskutimin e projektligjit të Komisioni i Ligjeve.

Kujtim Luli – Nëse e kuptova mirë pyetjen tuaj, bëhet fjalë se sa e lehtëson prokurori...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, nëse do të kemi një Polici Gjyqësore apo oficerët e Policisë Gjyqësore profesionistë në zbatim të detyrave të lëna nga prokurori, por edhe krijues në hetim, sepse ai

ka kompetenca të kryejë me iniciativë veprimtarinë procedurale penale, ai lehtëson edhe prokurorin, por kompletion dosjen për të pasur prokurori prova të bollshme dhe për të ngritur akuzën.

Në vlerësimin tim, në sistemin e drejtësisë penale, nëse do të ketë oficerë profesionistë të Policisë Gjyqësore që administrojnë në përputhje me ligjin provat dhe i paraqesin ato për prokurorin, nuk ka prokuror që mund të mos ngrejë akuzë me ato prova, nëse ato janë të bazuara në ligj për një çështje konkrete. Nëse prokurori ka një dosje me akuza të mbështetura në prova, nuk ka gjyqtar, që nuk jep fajësinë për çështjen. Pra, ky është sistemi. Themeli i veprimtarisë fillon me punën e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe përfundon me të gjitha shkallët e gjyqësorit. Nëse do të ketë themele të mira procesi penal, do të ketë efektivitet në ushtrimin e ndjekjes penale.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Luli për përgjigjet tuaja!

Ftoj kolegët që të kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Para se të votojmë, i jap fjalën zotit Braho për një ndërhyrje.

Spartak Braho – Vaso, mos e hapni më punën e pagës! Ti, unë dhe kjo zonja, që është juriste, e dimë shumë mirë që një gjë e fituar me ligj, nuk diskutohet më.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Braho!

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit, kolegë! Faleminderit, zonja Hysi!

Faleminderit, përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe gjithë të tjerëve për prezencën e tyre për komision dhe ndihmën për zhvillimin e kësaj mbledhjeje!

Nesër do të vijojmë me diskutimin nën për nen të këtij projektligji.

Edhe një herë, faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA